

Nr. 112 Prot.

Tiranë, më 11.05.2022

Lënda: Shqetësim mbi nismën për projektligjin për "Krijimin e Urdhrit Profesional të Inxhinierëve" dhe "... të Arkitektëve"

Znj. Lindita Nikolla

Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Znj. Belinda Balluku

Ministre e Energjisë dhe Infrastrukturës

Znj. Evis Kushi

Ministre e Arsimit dhe Sportit

Znj. Erinda Ballanca

Avokati e Popullit

E nderuar Znj. Nikolla, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Së pari më lejoni të shpreh konsideratat tona më të larta për Ju dhe institucionin që ju përfaqësoni.

Institucioni ynë, në bashkëpunim me institucione të tjera akademike dhe organizata të shoqërisë civile, risjell në vëmendjen tuaj një nisme për krijimin e Urdhrit të inxhinierëve të ndërtimit dhe Urdhrit të arkitektëve, e ndërmarrë sërish së fundmi nga një grup interesi i izoluar.

Ky debat që po zhvillohet në mënyrë të përsëritur nga një grup interesi i izoluar, nuk përfaqëson interesin e shoqërisë dhe të profesionistëve të fushës. E sidomos, interesin e atyre profesionistëve të rinj, që pikërisht për shkak të disa nismave arbitrare si kjo, zgjedhin të emigrojnë, pasi janë ndjerë të përjashtuar nga aksesin në qeverisje. Sa më sipër, reklamohet se kryhet në emër të integritetit në BE, por nuk është aspak e vërtetë, pasi BE nuk imponon asnjë detyrim në këtë aspekt.

Ne, sëbashku me homologët tanë (institucione apo bashkëpunëtorë të fushës) kemi vite që informojmë Ministrinë e linjës, Qeverinë, Parlamentin dhe Avokatin e Popullit. Jemi vlerësues ndaj profesionalizmit të tyre, të cilët kanë marrë në konsideratë qëndrimin tonë dhe të kolegëve deri tani dhe kanë bllokuar me vendosmëri nisma të tilla, pasi legjislacioni në fuqi ka zgjidhur të gjitha çështjet që pretendohen në këtë rast. Madje, i jemi mirënjohës Z. Gramoz Ruçi, i cili

personalisht dhe në bashkëpunim me Komisionin parlamentar, ka mbajtur qëndrim korrekt, 2 herë ndaj këtyre nismave. Po kështu, të njëjtin vlerësim maksimal shprehim edhe për Ministren Balluku dhe ekipin e saj, e cila ka mbajtur gjithashtu të njëjtin qëndrim.

Për më shumë, lutemi mund t'ju informojë në mënyrë të pavarur edhe Avokati i Popullit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilëve, gjithashtu ju jemi mirënjohës, pasi me korrektesë, si herët e tjera, edhe këtë rradhë, kanë dëgjuar ankimmimet tona brenda procedurës dhe logjikës ligjore.

Ne kerkojmë që Ju dhe Komisioni Parlamentar i linjës të bllokoni edhe në këtë rast nismën e marrë nga një deputete e Parlamentit. Kjo, pasi grupet e interesit nuk janë vetëm shoqata të caktuara, por edhe grupe të tjera formale dhe informale, dhe sidomos katedrat e Inxhinierisë së Ndërtimit në disa universitete të vendit, të cilat janë kundër kësaj nisme, dhe do ju adresohen gjithashtu ju. Si ish Ministre e Arsimit, kemi besim që ju do ta kuptoni dhe vlerësoni rolin e Universiteteve në këtë çështje. Aq më tepër, që praktiket e Urdhrave nuk janë të vetmet modele në BE. Madje, edhe në vendet ku operojnë, janë shumë të kritikuar dhe të denoncuar për korrupsion e abuzim. Pa folur për kontekste të ndryshme.

Hapja potenciale e Urdhrit të Inxhinierëve të Ndërtimit, në konflikt intrerresi me interesin publik, do të hapte udhën, që po kaq padrejtësisht, të hapej edhe Urdhri i Arkitektëve nga persona dhe grupe të caktuara të izoluar. Këto profesione në fakt, tashmë janë të rregulluara tërësisht me ligje, falë reformave të Qeverisë dhe nuk ka asnjë justifikim për shtesë filtrash, kostosh, burokracish, që thjesht do të institucionalizonin korrupsionin.

Duke ju falënderuar paraprakisht,

Me respekt,

REKTOR

Prof. Dr. Nikolla Civici

